

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Merkato jashtë kontrollit, UEFA ngre alarmin: 'Filluska' Premier League, rrezik për Europën
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/merkato-jashte-kontrollit-uefa-ngre-alarmin-filluska-premier-league-rrezik--i588372
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:25:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6805c4eb3b35de8a4701082d8b913ca8f142000523f726753801b79106518042
TEKSTI	77280571f2f9eba1e13032cd483539de084734f89d682c3a9b347b3254422443
PAMJA	470310f7c075566875d0a06b40d955ef090fde6d01dd9cf5a35af37411885ee3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	20cfb585e346c33077b9b7ecded27507e51282d67f34624a790488e383784508
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/20cfb585e346c33077b9b7ecded27507e51282d67f34624a790488e383784508>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le Si e komenton Brukseli, ceshtjen e Viora Hysenit? "Sistemi demokratik ka ndertuar imunitet ndaj korrupsionit", Rama: Aeroporti yne me i madhi ne rajon, ia kalon atij te fundit

Merkato jashtë kontrollit, UEFA ngre alarmin: 'Flluska' Premier League, rrezik për Europën



25 Shtator 2026, 17:45Sport TEMA



Rritja e madhe e kostove për transferimet e lojtarëve krijon një model "të brishtë" për klubet angleze, me pasoja të mundshme negative në gjithë futbollin europian. Alarmi vjen nga përgjegjësi i sektorit financiar të UEFA-s, Andrea Traverso, pas raportit vjetor të 'European Club Talent and Competition Landscap'.

Financat e klubeve në gjithë Europën janë bërë më "të brishta" për shkak të boom-it të shifrave të shpenzuara dhe rritjes së borxheve që lidhen me operacionet e merkatos, me klubet britanike veçanërisht të ekspozuara. Shpenzimet totale të merkatos së fundit verore për herë të parë kaluan tavanin e 10 miliardë eurove, me +8% në krahasim me 2025-ën dhe +43% në krahasim me 2019-ën, para pandemisë.

Ky fluks në fakt nuk është shparndarë në mënyrë uniforme. Klubet angleze janë përgjegjës të gati gjysmës së shpenzimeve totale. Dhe gati gjysma e kësaj shifre ka mbetur brenda vendit, sepse janë të vetmit në Europë në gjendje të përballojnë këto çmime. Vlera e transferimeve brenda merkatos angleze ka qenë më e madhe se shumta e të gjitha merkatoeve të tjera kombëtare europiane. Raporti flet për "shpejtësi të dyfishtë" dhe "polarizim" të merkatos.

Nëse nga një anë kjo gjë reflekton supremacinë financiare të Premier League, në anën tjetër e bën futbollin e saj më vulnerabël ndaj korigjimeve të merkatos globale të transferimeve.

"Vlerësimet vazhdojnë të rriten ndjeshëm, veçanërisht në merkaton angleze, duke shtuar presionin mbi rezultatin e ardhshëm financiar të klubeve, për shkak të kostove më të larta të amortizimit – nënvizon Traverso. – Aktualisht këto kosto kompensohen pjesërisht nga fitimet e konsiderueshme të kapitalit, por e gjitha kjo krijon një model më të brishtë. Klubet varen gjithmonë e më shumë nga inflacioni dhe likuiditeti i tregut".

Ky rrezik amplifikohet nga fakti se shumë blerje nuk likuidohen menjëherë. Pagesat shpesh shpërndahen në disa vite. Rezultati është një nivel në rritje i borxheve që lidhen me transferimet dhe varësi më e madhe nga fluksi i arkëtimeve të ardhshme për të financuar investimet e kaluara.

Një nga të dhënat më surprizuese është që klubet angleze kanë paguar mesatarisht 24 milionë euro për çdo lojtar të blerë, ndërkohë që kampionatet e tjera krvesore europiane kanë një mesatare më pak se 5 milionë euro. Nië sinjal i qartë i fuqisë së blerjes së Premier, por edhe i ekspozimit të saj ndaj një kolapsi të

Shprehja e vlerave të merkatos.

Raporti nuk përmban vetëm sinjale alarmi. Sezonin e kaluar, për shembull, pjesëmarrja e përgjithshme në stadiumet europiane ka arritur rekordin e 242 milionë spektatorëve, duke shënuar një rritje 15% në krahasim me periudhën para pandemisë. Premier është në krye, natyrisht, me 15.8 milionë të pranishëm, pastaj vijjnë Gjermania, Spanja dhe Italia.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Gjimshiti para Shqipëri-Bjellorusi: Synojmë të shkojmë për herë të tretë në European](#)

16:25 Sport / 1 koment

[Maran tregon 'sekretet' -Trajneri para ndeshjes me Bjellorusinë: Nesër nis aventura ime me Shqipërinë](#)

15:25 Sport

'FIFA duhet të reformohet për të mirën e futbollit' - Ligat e mëdha evropiane kërkojnë ndryshime në qeverinë e futbollit botëror

13:20 Sport

["Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar!" - Roberto Carlos trondit botën e futbollit: Humba 99% të pasurisë brenda një nate](#)

11:00 Sport / 7 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.